



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d, neni 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 31.08.2021, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 30.07.2021

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për procesverbalin e mbledhjes së katërt të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 30.07.2021.

Neni 2

Pjesë e këtij vendimi është procesverbali i datës 30.07.2021

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Najm Pira





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË GJASHTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 30.07.2021 (e Premte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Bajram Sokoli, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Lindita Demelezi, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, mjetet elektronike, zyrat e kryetarit.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e gjashtë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë. Më lejoni të përshëndes nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Para tri javë dite kemi humbur drejtorin e shërbimeve publike. Unë ju ftoj në shenjë respekti të nderuar këshilltar, ta mbajmë një minutë heshtje. Kujtim të përjetshëm! Kryesuesi i njofton rreth Covid 19. MAPL-ja e ka rikthyer një vendim të kuvendit që e kemi miratu në seancën e fundi, nga fakti që nuk e kemi cek kodin e nga do ti marrim ato mjete. Tani kalojmë tek pyetjet dhe përgjigjet, fjala është për ju.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Se pari isha ndal tek transmetimi i seancave, mirëpo ka qenë dashtë që me herët të kryhen fazat e prokurimit publik e sot të kemi transmetimin. Pyetjen e parë e kam: a është caktu dikush shef i prokurimit në Zyrën e Prokurimit, për shkak se tani duhet të hecin procedurat me tutje. Një informatë që na duhet ta dimë se çka ka ndodh me rrugën Viti-Korbliq. Pyetja tjetër: komuna sa borxhe ju ka mësuesve si shumë, sa kontrata mbi vepër i ka Komuna e Vitisë. Pyetje tjetër për drejtorin e financave: a janë pagu ata që kanë pësuar nga Covid 19. Një kompani në 2019, “Mont Maso”, e ka pas bërë një studim të fizibilitetit për lumin “Morava”: a është protokolluar qaj studim nga komuna po më duhet me ditë, sepse rast konkret Hani i Elezit, nga ky studim ka fillu bisedimet me Maqedoninë për shkak të ujit të ndotur që është, ndërsa ne nuk e dimë se çka ka ndodhë me ne.

z.Taulant Haxhiu: Të nderuar të pranishëm! Unë po lidhem me arrestimet që janë bërë në Viti. Është arrestu shefin i Zyrës së Prokurimit. Unë kam thanë që asnjëherë nuk kam bërë politikë, po ata që e kam thanë tash po dalin të vërteta. A keni dhënë ndonjë konferencë për shtyp për arrestimet që janë bërë në Viti, sepse komuna asnjëherë nuk ka dal me ndonjë deklaratë se për çka janë arrestu ata, sepse është arrestim me skandal që ka ndodhë. I nderuari drejtor Ramiqi, unë edhe në seancën e kalime i kam kërku kontratat në vepër edhe besoj që

sot i ki këtu, se kogjo shumë janë dhënë kontrata këto ditë. Sa i përket transmetimit, kjo po nënkuptohet si fushatë, sepse i kemi edhe dy tri seanca të fundit, e këtë e keni bërë për shkak që mos me i pa të këqijat e juaja opinionin ose qytetarët e Vitisë. Unë kërkoj që z.Aliu të ja jep një sqarim për këto arrestime edhe një herë po tham se kush do të jete zëvendësues i Fadil Abazit tani.

z.Nuredin Luftiu: Përshëndetje të nderuar koleg. Ju e dini që përmes mjeteve të informimit që kam vendos të ju bashkëngjitem LVV-së, kërkesa ime e parë për grupin të cilin kam qenë, të LDK-së, prej shefit të grupit dhe të gjithë juve të pranishmit, ju njoftoj që tani jam në LVV. Kryesues, unë jam anëtar i Komitetit për Komunitete, ai vend i takon grupit më të madh, unë prej sot nuk do të jem anëtar i atij komiteti. Tani vazhdoj me pyetjet. Për fillim e kam një peticion, i cili me iniciativën time bizneset dhe banorët e rrugës "Fehmi Maliqi", në Viti, bizneset e banorët e kësaj rruge, e cila gjendet prej Mediteranit deri në hyrje të Vitisë, ata kërkojnë, aty mungon infrastruktura komplet. Po ata fillimisht kërkojnë të ju bëhet trotuari dhe ndriçimi publik. Ju e dini se Mediterani është një nder firmat që ka më së shumti punëtor në Komunën e Vitisë, i ka dikun mbi 100 punëtor. Ata kërkojnë infrastrukturë. Kërkesa tjetër vjen nga banorët e fshatit Skifteraj, kërkesa e parë vjen për trotuarin i cili e përshkon rrugën "Luftëtarët e Lirisë", e cila përshkon rrugën për fshatin Remnik deri tek trafta, ndersa tek pjesët tjera janë disa lagje të cilat nuk kanë ndriçim publik, nuk kanë ndriçim publik e në disa raste ju mungojnë poqat. Tek pjesa tjetër e ku interesimi më i madhe i banorëve është të dinë diçka për ujësjellësin, për renovimin deri ku kanë shku procedura.

z.Naim Pira kryesues i kuvendit: Sa i përket peticionit, dijen procedurat e peticionit.

z.Zekirja Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Qytetarët e Smirës e kanë një shqetësim rreth prerjes dhe shkatërrimit të pyjeve, për çdo ditë i shehë traktorët që presin malin pa u penguar nga askush. E di që pyjet janë në kompetencë të ministrisë përkatëse, po ju lus të gjithë ata që janë kompotent komunal, duke u nisur nga kryetari, policia, inspeksioni, e sidomos mjetet e informimit publik, që të angazhomi të gjithë në vetëdijesimin e qytetarëve që t'i mbrojmë këtë pasuri që naj ka dhanë Zoti. E sa i përket peticionit, me vjen keq Nuredin se, unë jetoj në qat rrugë, e tek unë nuk ka ardh askush.

znj.Idajete Pira: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Është shqetësim i imi dhe i të gjithë punëtorëve që punojnë në Karitas, sepse nuk janë paguar që dy muaj, për të kuptuar se në çfarë gjendje pandemi jemi me vapë të madhe. Sipas informatave të zyrtarëve të Karitasit, i kemi kështu: kryetari i jon e ka sterngarkuar me punëtor dhe kjo është një nder arsytet, sepse asnjë komune në Kosovë nuk jav vanon pagat përpos në Viti. Edhe kisha bë pyetje, se a do t'i marrin tani pagat apo si do të shkon puna. Kam edhe një shqetësim tjetër për Pozharan, për ujësjellës. E kam cek edhe më herët, e ujë me shume nuk kemi se sa kemi. Prapë po e potencoj, edhe kur të vjen uji, dy ditë nuk mundesh me e shfrytëzu, sepse është krejt i ndotur.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Mos transmetimi i seancave a është i qëllimshëm? Kompetencë e kujt është organizimi i transmetimit, kryesuesi apo dikush tjetër. Unë mendoj që kjo është e qëllimshme, po para se i kishe bërë pyetjet, kisha pas dëshirë ta shoh kryetarin këtu e ta shikojmë njëri tjetrin në fytyrë dhe konkretisht ta kisha pa kryetarin, çka po ndodhë me këto burgosjet e fundit. Plotësisht jam me Taulantin kur bëni pyetje për arrestimet: çka mund të na thoni për këto burgosje. Sa kontrata kanë mbet të panëshkruara kush do t'i nënshkruan këto kontrata, sepse këto ndikojnë tek mirëqenia e qytetarëve. Pyetja tjetër është, pasi që jemi në kohë zgjedhje, po e shofë që shumë gjëra janë duke u bërë, apo para përgatitë. Unë kam disa informata, po njëri nga këto do ta themë: si është e mundshme që ish shefi i ofiqarisë Habib Halili, 10 vite është paguar si shef i ofiqarisë, kurse punën e ka kry dikush tjetër, pra, Mergjan Sahiti? Si është kjo e mundshme? Pra, personi në fjalë, zotëri Habibi del në pension, prapë zotëri Merxhanit mund t'i kthehet e drejta që të paguhet si shef. Ku qëndron dhe si është e mundshme që 10 vite të jete kjo shkelje. Unë po supozoj që kjo është e vërtet, po nëse ka diçka tjetër, mund ta thoni ju. Pse ka emërime apo gradime në baza të lidhjeve familjare apo qëllime të përfitimeve të fushatës. Kjo është e paevitueshme, mirëpo për të gjitha këto veprime dhe pse nuk janë mediat

kjo duhet të jetë dikun e shkrume në mandatin e ardhshëm të gjithë ta kenë të kuart, ne do t'i shikojmë të gjitha, edhe kontratat e paligjshme edhe të gjitha këto dhe do t'i shfuqizojmë.

z.Naim Pira: Kompetencë e kryesuesit të kuvendit nuk është. Me që nuk është, është e Zyrës për Informim. Zyra për Informim minutazhen e ka përcjell, ajo e cila e ka pas tenderin me minuta dhe i ka skaduar.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kam një pyetje për drejtorin e financave. Në seancën e kalume thatë që jeni transparentë. Unë kam bërë disa kërkesa për dokumente zyrtare. Njëra më është refuzu. Këtu thotë me arsytim, po realisht nuk është ky arsytim, nuk me keni dhënë asnjë arsye. Tjetra është, që dy here jam tu e bërë një kërkesë edhe nuk më keni kthyer përgjigje hiq, nuk po muj me e kalu këtë, e kam bërë prapë me 9 korrik, nuk më keni kthyer hiq përgjigje. Kërkesa ka qenë për punësimet me kontrata mbi vepër, që janë bërë në komunën tonë në Maj-Qershor. Kam një pyetje për drejtorin e inspeksionit. Drejtor, banoret tek banesa e verdhë, që gjendet afër shkollës "Bafti Haxhiu", kanë probleme me podrumin e tyre, me ujësjellësin, me ujëra të zeza. Po besoj që është mirë me dal me analizu këtë situatë, sepse është një gjendje e tmerrshme atje. E kam marr edhe një shqetësim tek banesa këtu mbi ndërtesën, mbi sharrin. Banorët e kanë bërë një petition që e kanë dorëzuar tek ju po edhe në stacion të policisë për shkak të zhurmës së madhe që po ju bëhet. Unë e kuptoj që është një situatë mjaft e ndjeshme për shkak që me ardhjen e mërgatës, e dimë që mërgata kanë dëshirë me dal me shoqni e me familjar, mirëpo banorët që janë këtu po përballen me zhurma jashtëzakonisht të madhe, mendoj që duhet të gjeni një zgjidhje.

z.Bajram Sokoli: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ju njoftoj që kam dal në subjektin politik të PDK-së.

z.Sejdi Emiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në këtë kohë të nxehtë, çështje kryesore që duhet me diskutu ndoshta është çështja e ujit, sepse kemi nevojë më shumë se kurrë për ujin, kemi shumë ujësjellës që janë të përfunduara. Pyes, kur kanë mu përfundu këto, sepse me të vërtetë është çështje jetike dhe urgjente që duhet me e bërë këto. Drejtori i financave ndoshta edhe e kemi tepër, mirëpo ujësjellësi është duke u kyq nëpër shtëpi, shpuarjet të cilat i keni premtu, mundësisht me naj bërë ato që kanë mbetur gjysmë qytetar, po presin mu kyq, Nuredini. E përmendi që e ka bërë një petition me bizneset, është i qëlluar, sepse unë shumë herë e kam kërku që ajo pjesë të jetë funksionale dhe t'i gëzojnë shërbimet elementare bizneset.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam dy pyetje. Kompania e pastrimit në Viti, që dy muaj nuk i ka pagu punëtorët e vet, ku është faji, a është faji i kompanisë papërgjegjësia e tyre, apo i ka skaduar kontrata, apo është papërgjegjësia e juaj. Nuk ja keni bart paret për me bërë pagesën dhe e dyta që për mu ka qenë gjatë tërë vitit e pashmangshme, është çështja gypit. Tash kam pyetje konkrete për zëvendës kryetarin, kur do të bëhet ndarja e gypit të vjetër për me e furnizuar Vitinë me ujë, dhe do të përdoret gypi i ri, d.m.th kur do të furnizohen qytetarët me gjithë kapacitetin që ka uji në Letnicë nga gypi i ri që është vendosur që dy vite. Dhe një çështje tjetër, ndoshta Viti që 10-12 ditë bërllugon e ki në të gjitha lagjet, nuk e di qysh me quajt këtë kohë ma të nxehtë, ku është temperatura shumë e lartë, 39 gradë, e 10-12 ditë bërllugu pa u hek nga qytetit, kjo po më doket e patolerueshme, ku është shkak.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam pas disa pyetje, po pasi që drejtorët mungojnë me arsye, po i la pyetjet për seancën e radhës.

z. Bekim Azizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Një pjesë e çështjeve u diskutuan. Ju shprehë ngushëllime të gjithëve për drejtorin e shërbimeve publike. Sot, sipas rendit, ka qenë dashur me ardh edhe informata e kryetarit, sepse vetëm informata për gjashtëmujorin. Pse nuk ka ardh kjo informatë, kisha kërku në emër të grupit që ta mban një seancë të jashtëzakonshme vetëm për informatën e kryetarit, sepse besoj që kemi mjaft të bisedojmë për këtë gjashtëmujor. Një pyetje e kam, se për tërë mandatin nënkryetari dhe kryesuesi na kanë lodhur sa herë kemi folur për punë konkrete, për shkeljet që ne i kemi mëndur që po bëhen, çdo herë na kanë ndërpre. Që ku është prokuria, gjykata, tani prokurorin gjykatën i keni nëpër zyrat e juaja. Nuk po hi në atë

çështje, unë vetëm po pyes, a është marr naj masë administrative prej komunës, për personat që janë në procedurë, naj suspendim apo naj veprim. Listën e Karitasit ka qenë dashur me naj pru ju drejtoresh. Muajin e kaluar e pate seancën e parë, të respektova, po sot ka qenë dashur me pru listën e personave me Karitas. Edhe taksistat në qytet janë tu marr paga me listat e tua. Prokuroria për qet punë është. Seanca e tetë është që po e kërkojmë këtë listë. Ki taksist që ka marr pagë, për qeta po i kërkojmë listat.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Fillimisht ju bashkëngjitëm ngushëllimeve për drejtorin. A është caktu shefi i prokurimit ishe një pyetje. Po është caktu një shef i prokurimit, Hajrush Kurteshi. Në këtë drejtim kemi qenë bukur të hendikepumë, kemi pas vetëm dy në kuadër të shërbimit civil që i plotësoj kushtet dhe njerin nuk e kam emëru unë, sepse ka qenë si dëshmitar i rastit në fjalë dhe alternativë e vetme ka qenë Hajrush. Pyetje ishte, sa pare i ka borxh komuna mësuesve. Asnjë borxh nuk ja ka komuna mësuesve, janë kontratat kolektive nga niveli qendror dhe që e ka obligu komunën, e kurrë pare nuk i ka qit dhe ata po i fitojnë kontestet me gjykata. Momentin kur i kishe qit të destinuar ato mjete për ato, unë besoj që krejt mësuesit i kishin marr. Pyetje ishte, sa kontrata janë mbi vepër. Është një numër bukur i madh, unë e kam thanë një arsye. Ne i kemi dikun 23 pozita që kane dal në pension, pozita që kemi pas rast kanë humb jetën e nuk kemi mujt me i zëvendësu për shkak të mungesës së infrastrukturës ligjore. Ishte pyetje për çështjen e studimit të fizibilitetit: a është e përfundum kjo nuk e di, do të shof se deri ku ka mbërri kjo punë. Pyetje tjetër ishte: a keni mbajt konferencë shtypi për të arrestuarit dhe çka keni ndërmarr. I nderuari këshilltar, asnjë dokument nuk e kemi nga ana e prokurorisë apo hetuesisë, të cilët na kanë ardh ashtu qysh e ke dëgju ti problematiken, qashtu jemi të informuar edhe ne, e konsideroj se nuk kemi nevojë me e mbajt asnjë konferencë shtypi përderisa nuk e dimë gjendjen reale. Ajo që është kërku për me zëvendësua është zëvendësua, ajo çka është me rendësi kemi kerku edhe ligjin me ndërmarr hapa komuna, në këtë rast me i suspendu, e kompetencë e tillë paska kalu në kuadër të gjykatës dhe gjykata e bien një vendim të tillë. U ceken trotuaret dhe ndriçimi. E di që tash kërkohet një angazhim me i madh, është i domosdoshëm trotuari dhe ndriçimet, po këto janë kapacitetet tona. Ekremi e përmendi edhe ujin, kam pas brenda 10 dite dy takime me përfaqësuesit e CDI-së. Sipas informacioneve që kane pritët shpejti mu leshu ujësjellësi në Skifteraj, janë eliminu të gjitha defektet. Zekë, kemi pas shume herë takime rreth prerjes që po na shqetësoj të gjithëve, po i kemi 5-6 roje te pyllit të cilët nga toleranca shkatërrimi i pyjeve është në maksimum. Doktorëshë, mos u shqetëso, se sa jam në informacion, i kam marr pagat, unë i kam informacionet që janë pagu. U tha që ujë më shumë nuk ka, se sa ka nuk e di, për këtë është "Hidromorava", mundesh me i bë pyetjet. U ceken për te burgosurit, ne ende asnjë informacion nuk e kemi zyrtar. Krejt e dimi ato çka i kemi ndëgju përmes mediave. Ishte një pyetje, se si mundet një shef i ofiqarisë të paguhet. Ligji i cili është në fuqi, që është dashtë me e shiku thotë: nëse një person nga pozita e caktuar, pa fajin e ti ja ndërron vendin e punës, nuk ke të drejtë me ja prek pagën, dhe Habib Halili ka qenë i emëruar shef i ofiqarisë, kur Hysen Ymeri ka qenë i suspenduar, dhe pas një kohe kur u kthy, këtë e kanë ngarkuar me një referat tjetër, pa ja cenu rrogën të cilën e ka pas dhe ai ka shku në pension. Tani që Merxhani nuk e ka koeficientin 7.5 ose 8, po njoftohem prej teje, se nuk më kanë bë përshtypje këto. Tek banesa e verdh, edhe tek unë kanë qenë disa banor, kemi intervencu aty. Sejdi, edhe ty edhe Ekremi po ju përgjigjem, në takimin e fundit që e kam pas me Astritin e CDI-së, ka qenë shumë shpresëdhënës sipas meje. Ai me premtion se, përfundimi i muajit Gusht do të jete fshatrat të cilët i keni kalu ju do të përfshihet edhe Gushica. Shumica e fshatrave janë në fazën finale, sipas atij, sepse ai i përcjell kompanitë. Edhe çështja e gypit të ri që e ceku Ekremi, ai është tu funksionu, por megjithatë kapacitetit i ujit në përputhje me harxhimet që e bëjnë qytetarët, është problematikë me mrri uji në katin e dytë. Unë në këtë drejtim jam amater, ama po ju referohem njerëzve që janë kompetent për këtë punë. Ushtrues të drejtorit të shërbimeve publike nuk kemi ende, e kemi një vendim që unë e kam sjellë, ku drejtorët zëvendësohen me njeri tjetrin. Listat e Karitasit, e kërkon Bekimi. Këto lista mundesh me shku ne Karitas me i marr, kur do që të duhen, sepse ata janë kompetentë me t'i dhanë këto lista.

z.Jakup Demiri: Nënkrjetar, tek puna e shefit të prokurimi, unë po të tregoj sinqerisht çështjen e Hajrushit. Unë mu kanë nuk e kisha vendos, unë kam bisedu shpesh me Hajrushin, muhabet që kemi bë për 8 vite, një dokument kurrë tha nuk me ka lan ai njeri me e përcjellë se si duhet, sepse ai është shumë dinak i madh, e ka fjalën për Fadil Abazin. Liridona ka kërkua qasje në dokumente zyrtare që dy muaj e më shumë nuk e lejoni, nuk ja jepni dokumentet zyrtare që i ka kërkua.

z.Hasan Aliu, nënkryetar: Jakup, po me doket hiq nuk me paske përcjellë. Nëse ti mendon që me i mirë është televizioni se sa procesverbali, ke gabu, se televizionet janë private, e ky procesverbal të cilin ju diskutoni, ky ka me pas vlefshmëri edhe afatshmëri për diskutimin tanë. E thave që i kemi bë presion Hajrushit. Unë thash pas kërkesës time te vazhdueshme, të cilën ja kam bë ndoshta duhet me qu në komision disiplinor pa dashjen time, sepse edhe është e drejtë e eprorit me e ngritë në pozitë më të lartë, sepse është ekonomist, është i çertifikuar dhe pikërisht për këtë zgjidhje tjetër ne nuk kemi, pasi unë nuk e kam kërcnu. Po zgjidhje tjetër nuk kemi, pos nëse t'i referohesh dikujt, ja thu të vërtetën, nuk është presion, nuk kam pas tjetër, se banvaki nuk e kisha bë hiq, e Hajrushit ka fillu tash, përkrahjen do ta ketë të plotë, aspektin teknik do të ja mbulojmë.

z.Jakup Demiri: Nënkrjetar, për ato qëndrimet që unë i kam e ku i ka edhe subjekti im, na i parashtrijmë, ne i diskutojmë çështjet qysh i shohim. Unë e thash atë që me ka thanë ai djali.

z.Samet Idrizi: I nderuar kryesues, të nderuar koleg, e ju të pranishëm. Unë personalisht jam befasu kur e kam lexu, që licenca ju është marr nga USHP-ja, e ku me automatizëm ZKA-ja nuk e ka suspendu të paktën zyrtarin e prokurimit. Aty shkruan në mënyrë decitive në ligj, në momentin që ty të merret licenca, menjëherë caktohet tjetri edhe unë sa e njof ligjin që 17 vite, pavarësisht se prej kujt ka ardh propozimi me u mundu me e vazhdu me arsyeu edhe përmes organit tjetër, me arsyeu që me ja kthy licencën. U bë një gabim shumë i madh. Tash nuk ka nevojë kërkush me bë përpjekje me e arsyeu. Unë nuk ja kisha dashtë kurrkujt një gabim të tillë që e ka bë kolegu im.

z.Taulant Haxhiu: I nderuari nënkryetar, në seancën e kalume thamë, që ju ka kthy licenca shefit të prokurimit, dhe ti më thave nuk banë me i akuzu njerëzit, nuk banë me i ofendu. Unë të thash edhe në seancën e kalume, që nëse ju ka kthy licenca, është jashtëligjshëm dhe ai njeri nuk e ka vendin këtu e ku ato dulen, po unë e di që ti nuk je i tillë, e sa për informim, qytetarët duhet me e ditë prej komunës së vet ka qenë dashur me dhanë një informatë ju komuna.

z.Hasan Aliu, nënkryetar: Unë konsideroj që nuk kam qef mu bë avokat i së keqes, po ti e dinë se para meje e ki pas vendimin që ju ka rikthy licenca, unë asgjë nuk kam thanë, unë kam thanë ja ka marr edhe ja ka kthy licencën organi kompetentë. E tash ndodhi kjo e dyta, edhe duhet t'i presim organet e drejtësisë.

z.Nuredin Luftiu: Nënkrjetar, me gjithë respektin që e kam për ju, sa kam qenë pjesë e LDK-së, ju e dini që një ndër këshilltarët më së shumti që kam ngrit çështjen për mirëqenien e qytetarëve, kam qenë unë.

z.Ibrahim Rama drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pyetjen nga Jakup Demiri që ka të bëjë me rrugën Viti-Korbliq, ka përfundu këtë projekt dhe është kërkua leja nga Urbanizimi kemi pas pyetjen nga Liridona e ka bë edhe deputetja e Republikës së Kosovës, Fitore Pacollë. Jav kemi dërgu lejen e ndërtimit, është mirë tash, një lajm i mirë që me rishikim të buxhetit, ky projekt vetëm është vërtetu që mundet me qenë funksional. Pardje u votu ky. Pate pyetje për pagesat, për personat që kanë vdek nga Covid 19, janë pagu. Nga mbledhjen e KPF-së, shefi i GP të PDK-së dhe të LVV-së, listat e punëtorëve që punojnë me kontratë mbi vepër dhe listën e pagesave të shpenzimeve gjyqësore. Ato i keni sigurish, pjesë tjetër e pyetjeve ishte edhe nga Liridona, qasje ne dokumente zyrtare. Unë asnjëherë nuk ka ndodh që nuk ju kam përgjigj një kërkese zyrtarisht. Pyetje tjetër ishte projekcioni i ujësjellësit në fshatin Goshicë, është fjala për disa shpime që duhet me kalu nëpërmes rrugës, besoj që kompania, kryetari i komunës dhe kryetari i fshatit, kemi bisedu e besoj që do te kryhen edhe këto. Ekremi e bëni një pyetje që ka të bëjë me pagesën e punëtorëve të pastrimit publik, janë vonu këto pagesa, kjo është e saktë, po për hirë të mungesës së punëtorit në Zyrën e Prokurimit, nënshkrimin e kontratës, kështu që tash me

fillimin e punës së zyrtarit të prokurimit, besoj që edhe kjo ka mu zgjidh. Ishte pyetje edhe për problematikat e gypit të ri të ujit, projekcioni ka përfunduar, pagesa është bërë, një pjesë e ka financuar komuna, një pjesë CDI-ja, po sasia e ujit, përpunimi tek fabrika duhet të rritet kapaciteti, me pas shtypje të mjaftueshme dhe ujë të mjaftueshëm, që me pas qytetarët ujë edhe në katet e larta. Pra, nuk ka sasi të mjaftuar të ujit.

z.Jakup Demiri: Për rrugën e Korbliqit, të pyeta pikërisht për këtë, sepse në rishikim të buxhetit ka kaluar, po se di a do të fillojë këtë vit punimet.

z.Skender Ahmeti, drejtor: Ishin disa pyetje për drejtorin tonë Zeka. E përmendi çështjen e pyjeve, edhe kërkoj prej autoriteteve të inspeksionit me marrë masa. Po të thamë sinqerisht, që në autoritet kompetent nuk jemi.

z.Vehbi Rama: Unë vetëm deshta me përsëritë kërkesën e seancës së kaluar, rruga "Rexhep Bislimi", trotuarin e ka katastrofë: kur do të rregullohen? Edhe tjetra, ambulanca në Zhiti.

z.Ramadan Deliu: Pyetje për drejtorin e inspeksionit: a keni ndonjë plan që me dalë taksistëve me ja bërë vijat e verdha edhe me ja shkruar secilit, sepse po i lanë krejt kerret private.

z.Skender Ahmeti, drejtor: Kjo është një çështje shumë problematike, është krijuar një komision prej kryetarit, janë tu përgatit për këtë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Për seancën e gjashtë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, kemi para këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa.

2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2021.

3. Propozim vendim për caktimin e komisionit për intervistim, vlerësim dhe poentim të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkurset publike për pozitat drejtor, zv drejtor të shkollave fillore - mesme dhe çerdheve të fëmijëve të Komunës së Vitisë.

Dhe na kanë ardhur dy propozime vendime. Njëri është rishikim për ndihmat që do t'i japim strehimores, dhe si pikë tjetër kemi: propozim vendim për dëgjim publik rregulloren për taksa, ngarkesa. A jeni që ta miratojmë rendin e dite me këto pika? Konstatohet që u miratu rendi i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e KK-së

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat rreth procesverbalit. A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

z.Zekirja Zuka: Kërkoj që në faqen e 9 të materialit ku kame than që kryetari i LDK-së në Smirë është zgjedh Granit ketu kame than gabimisht sepse kryetar është zgjedh Florent Ymeri kërkoj që kjo të futet në procesverbal.

z.Remzi Salihu: Te faqja 5, kisha me ndërhyrë pak tek diskutimi im, është një fjalë që ja jep kuptimi fjalës këtu, dhe tek faqja 8, do të shtohen këtu tek rreshti i katërt, ku thuhet: "MASH-i i ka lejuar 620 pozita në arsim", dhe këtu mendoj që duhet t'i shtohet, sepse e kam diskutuar unë, kurse ju keni parapa 825 pozita.

Kryesuesi z.Naim Pira: E hedh në votim procesverbalin me këtë vërejtje të Remziut. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2021

z.Ibrahim Rama, drejtor i financave: Të nderuar këshilltar komunal! Zakonisht në çdo tre muaj gjatë ekzekutimit të buxhetit, Drejtoria për Financa ka për obligim, që kuvendit komunal përmes KPF-së t'i raportoj

për realizimin e buxhetit për periudhën janar-qershor 2021. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetjet shitesë jam në dispozicionin e juaj.

z.Naim Pira, kryesues i kuvendit: Hapi debat për këtë pikë.

z.Jakup Demiri: Pasqyrat për të cilat po diskutojmë, vërehet që nuk janë shfrytëzuar mirë në përqindjen e duhur. Drejtori i ceku disa arsye, po unë po ndalem tek shpenzimet si pagesa për vendimet gjyqësore, ku janë 109 mijë euro dhe nga i cili kod janë pagu pasi që këto nuk planifikohen, tek pagat kodi 13118 dhe 13320 shpenzimet e telefonisë fikse dhe telefonisë mobile, e kanë vlerën 12 mijë e 777 euro. Më doket që në këtë kohë të teknologjisë informative është shumë e madhe, tu e pas parasysh që këtu kemi edhe shpenzime të internetit 420 euro, mirëmbajtja e autorrugëve lokale, kodi 14031 dhe mirëmbajtja rutinore 14060, këtë nuk po e kuptoj pse kemi nevojë me pas këtë, këtë kod nuk e kam pa me herët, shërbimet kontraktuese tjera. Tek Drejtoria e Bujqësisë, tek subvencionet, në faqe 25 e ki 37.39% a ka naj arsyetim apo çka po ndodh duke e pas parasysh që sivjet jemi në vit zgjedhor, edhe e dimë se si ka ndodh para katër vite. Tek donacionet, këtë vit nuk kemi donacione, çka është në pyetje, a është humb besimi apo çka pse po na hupin donatorët. Të hyrat vetanake të bartura, unë e di që kemi pas të hyra vetanake.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pasqyrat financiare të gjashtëmujorit të parë, unë parimisht po thamë se është shqetësim tek subvencionet, pjesa e subvencioneve ku janë 413 mijë euro që janë të aprovuara apo të planifikuara për këtë vit, vetëm 50 mijë euro i ke shpenzu. Përnime është bë modë, që subvencionet tu e ditë që është vit zgjedhor, tu e ditë që çdoherë i keni keqpërdor subvencionet në fushatë zgjedhore, edhe në heshtje zgjedhore keni shpërnda subvencione. Ky është një shqetësim që shuma me e madhe ka met për pjesën e dytë të vitit, mendoj që ka pas nevojë edhe në gjashtëmujorin e parë të jet me e shfrytëzueshme, një shumë më e madhe, po kjo është e papranueshme se sa u shfrytëzua. Tek shpenzimet kapitale, tek 2 milion e gjysmë që janë të parapamë 870 mijë, në mesin e 870 mijë janë kanë kontrata dy tri vjeçare, që ajo e ka rrit këtë, mirëpo a ka në mesin e qetyre 870 mijë euro përfitime qe janë bart prej vitit të kaluar apo janë vetëm të vitit 2021. Te shpenzimet e ndryshme shëndetësore, janë të Karitasit që kontrata sivjet, edhe kjo është vlerë shumë më e madhe se vitin e kaluar, por edhe kontrata më e shtrejt këtë vit e dimë që është vit zgjedhor. Tek pajisjet tjera, është nëse bëhet një krahasim me periudhat e njëjta të vitit të kaluar, çka ka mujt me pas tek pajisjet tjera, p.sh.: është 100% me shtrejt, a shpenzimi i njëjtë kodi 13509 pajisje tjera. Po lidhem tek kodi 13630, furnizime mjekësore sivjet gjashtëmujorshi i parë 2900 euro e vitin e kaluar, gjashtëmujorshi i parë 38 mijë euro është shifër shumë e dallueshme, a qaq pak kemi bë furnizime mjekësore sivjet që nuk ka pas nevojë, e kur ne e dimë që bukur shumë ka pas nevojë, se aty i kemi punët keq. Tek furnizimet e pastrimi në gjashtëmujorshin e parë të vitit të kaluar ka qenë 29 mijë e 600 euro, ndërsa sivjet është vetëm 2800 euro tek çështja e pastrimit, furnizim me elemente për pastrim. Është e nevojshme, ne e dimë tek shkollat e ne institucione, diçka ka e pash shqetësuese nëse e përcjellim regjistrimin, sigurimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve është më shumë se dyfish me shpenzime që i bëjnë këto automjete, është shqetësuese mirëmbajtja e automjeteve se sa shpenzimet e automjeteve, kjo nuk duhet me ndodh. Tek mirëmbajtja e ndërtesave, në gjashtëmujorshin e vitit të kaluar, 56 mijë euro, sivjet 80 mijë euro, a është shtu numri i ndërtesave objekteve apo pse ka ndodhe kjo.

z.Taulant Haxhiu: Tek mirëmbajtja e ndriçimit publik dhe dekorimi i qytetit për festat, 30 mijë e 565 euro, po me doket një shumë shumë e madhe. Tek mirëmbajtja e ndërtesave e tha Bekimi, 80 mijë e 337 është vlerë më e madhe se vitin e kaluar. Nëse mundesh me më dhënë përgjigje për këto.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë me kohë kam pas thanë, që duhet me e rrit planifikimin e të hyrave vetanake, sepse shpenzimet i kemi rrit gati në të gjitha zërat. Tek investimet kapitale, është vlera shumë e ulët. Mu më pëlqej shumë Bekimi, që e ka kap situatën. Besoj që duhet me pas mjete edhe të vitit 2020, që na kemi pagu këtu. Ju është tërheq vërejtja Zyrës së Prokurimit në ato tendera që po i toleron, po qet kritere diskriminuese dhe kjo vonesë ka ardh si shkak i kësaj. Këto i kam lexu unë nëpër gazeta, është

mirë tash kryetari i komunës po edhe drejtori i financave e ka të drejtën me ja terjek vërejtjen. Tek vubvencionet e kame vetëm një pyetje nese subvencionet janë vetanake pse nuk janë shpërnda deri tash.

z.Remzi Salihu: Kam disa pyetje, p.sh.: tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, kodi buxhetor 14020, mirëmbajtja e ndërtesave. Kemi një shumë 80 mijë e 337.14 euro. Përpos që mendoj që është një shumë bukur e madhe, unë du ta potencoj edhe momentin se sa ka ndiku kjo shumë në punën e kësaj çështje, kur tek banesa e verdh që quhet aty prapa përmendores, atje kam qenë personalisht kam vizitu podrumin e kësaj banese. Ta keni me dije se, aty është tmerr, aty munden me fitu ndonjë epidemi, nuk di tash konkretisht a është ajo banesë nën juridiksionin e komunës apo si do që të jet ajo gjendje nuk tolerohet. Pastaj tek prezantimi analitik i investimeve për periudhën janar-qershor 2021, besoj që hartuesi i këtij dokumenti e ka të kjart se çka do të thotë prezantim analitik. Jepen disa përshkrime të investimeve, furnitori, etj etj; po megjithatë nuk jepen se ku janë bë këto investime. P.sh.: asfaltimi i rrugëve rurale, nuk po shof se cilat rrugë janë bë, përpos që kompanitë të cilat e kanë fitu ose e kanë kry këto tender dhe nga krejt këto që është servu në këtë dokument, shuma totale është 800 e 7 mijë e 733 euro. Për çudi, nga kjo shumë po e përsëris edhe njëherë, në asnjë moment nuk përdoret apo nuk thuhet se është ndërmarr diçka për ujë të pijshëm. Ndoshta këtu mund të jav jap një lavdatë, sepse këtë vit janë kursy dikune 40 mijë e diçka euro. Tek uji i pijshëm nuk e di a ka qenë mungesa apo nuk e di si ka ndodhë.

z.Ibrahim Rama, drejtor: Disa pyetje ishin për vlerën e prezantuar në buxhet për disa shpenzime të caktuara për telekom. Mirëmbajtje të rrugëve. Për mirëmbajtje të aksionit, një gjë është e sigurt, çdo shpenzim që e kemi pasqyru në këtë pasqyrë financiare, bazohen në kontratat e nënshkruara nga drejtoritë përkatëse, e kontrata e nënshkruara nuk kanë qenë të njëjta as në njërin vit, mirëpo për të gjitha informatat shtesë mundeni me e kërkua kontratat e vitit të kaluar edhe kontratat e këtij vitit dhe me e pa atë që ju intereson juve. Unë ju kam thanë që buxheti i vitit 2021 duhet mu shpenzu ashtu qysh është planifiku edhe qysh është në kontrata. Pjesa dërmuese e shpenzimit të buxhetit është përmes kontratave. Subvencionet janë mjete kryesisht 100% vetanake, nuk varen nga niveli qendror. Subvencionet janë të planifikuara tek të hyrat vetanake që grumbullohen. Mjetet i kemi të siguruara, shpenzimi i subvencioneve tek Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Shëndetësisë, të Kulturës është sipas dinamikës dhe planit të prokurimit, të cilin e ka dorëzuar për me shfrytëzuar për subvencione. A ja ka qëllu në bazë të kohës, unë besoj që përgjegjësitë e sektorëve e dinë më së miri. Të hyrat vetanake ishte nga Sameti. Unë e kam thanë gjithmonë, nuk jam lavdu kur ka pas tejkalim të përqindjes të të hyrave vetanak, për arsye se, mirënjohja ju takon qytetarëve. Ishte pyetje për vendimet gjyqësore, pjesa dërmuese janë të kontratës kolektive, përveç këto që i kemi pagu, kemi edhe një numër të madh në pritje. Na ka ardh një listë tani, të investimeve kapitale, pagesa prej 800 e 70 mijë euro. Po, është e vërtet, nuk është krejt kjo shumë e viti 2021 ka punë që janë kry në vitin 2020, e që ju ka bë pagesa në këtë vit. Një rast konkret është pagesa për rregullimin e rrugëve me zhavorr, 200 e sa mijë euro, është faturë e vitit 2020 që është pagu në vitin 2021. D.m.th, ka pjesë të projektit që janë pagu në këtë vit. Donacione nuk ka në realitet, ka, po Ligji për Financat Publike thotë, që donacionet pasqyrohen në raportet financiare, ato donacione që vinë me buxhetin e Komunës së Vitisë. Tani prej buxhetit komuna i shpërndan në të mirë të qytetarëve. Në këtë vit nuk kemi pas donacione që na kanë qit, donatorë të ndryshëm në buxhetin e komunës, e përndryshe e kemi pas ambulanten e Terpezes, e kemi fitu me donacion nga Ambasada e Kuvajtit. Ata i kanë dhanë 50 mijë euro, e në 20 mijë si participim. Ishte një pyetje për servisimin e kerreve. Kerret janë të vjetra, e normal kanë defekte të mëdhaja.

z.Bekim Azizi: Te mirëmbajtja e ndërtesave, ke pyetja konkrete: a është rrit numri i ndërtesave që ka mu mirëmbajt, apo kontrata ka dallime.

z.Ibrahim Rama, drejtor: Është e mundeshe me pas hapësira më shumë, mundet me pas edhe çmime të ndryshme, sepse përgjigjen e sigurt nuk e kam tani për tani.

z.Remzi Salihu: Tek banesa e verdh, çka po ndodhë aty?

z.Ibrahim Rama, drejtor: Ajo banesë është nënë përkujdesjen e Habitatit, nuk është aset i komunës edhe pse Drejtoria e Shërbimeve Publike shpeshherë ka interevnu për ato probleme që kanë ndodh në atë podrumin e asaj ndërtese.

z.Naim Pira, kryesues i kuvendit: Faleminderit për të gjithë!

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim vendim për caktimin e komisionit për intervistim, vlerësim dhe poentim të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkurset publike për pozitat drejtor, zëvendës drejtor të shkollave fillore - mesme dhe çerdheve të fëmijëve të Komunës së Vitisë

z.Basri Aliu, drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Sipas udhëzimit administrativ numër 151/2020, vitin e kaluar e kemi marr një vendim, po në bazë të udhëzimit tjetër që ka qenë, e kemi formu një komision për pranimin e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve dhe tani ka ndryshu udhëzimi, e ku ne jemi të obliguar që komisioni ta sjellim para juve, sepse udhëzimi e thotë kështu, që të jetë një nga drejtoritë e DKA-së, i cili i ka 3 vite përvojë pune në arsim dhe nja të jetë jashtë drejtorisë, po të jete i nivelit arsimor dhe një anëtar nga MASH-i. Si vëzhgues kanë me qenë edhe këshilli i prindërve dhe një e sindikatës. Unë po i jap propozimet, e ju e keni të drejtën ta miratoni këtë. Ne si drejtori kemi mëndu, që Zjadin Ahmeti të jete anëtar i komisionit dhe Vjollca Zejnullahu. Vjollca i plotëson kushtet, sepse e ka masterin, e ku kërkohet një, ndërsa Zjadini është i vetmi zyrtar që e ka përvojën e punës. Kërkoj nga ju që të miratohet ky propozim vendim.

z.Naim Pira, kryesues: Hapi debat për këtë pikë.

z. Bekim Azizi: Në bazë dokumentit që e kemi tek neni 2, thotë: anëtar i komisionit nga këshilli i prindërve. Kush është Vjollca Zejnullahu, sepse nuk e di çka punon edhe Zijadini, sa kredi i ka Zijadini.

z.Basri Aliu, drejtor: Udhëzimi administrativ e thotë, njëri nga anëtarët e komisionit ti ketë 300 kredi, njëri duhet me qenë, ndërsa Zjadini i ka 240 kredi, e Vjollca është drejtoresh e shkollës në Ramjan dhe i përgjigjet udhëzimit, sepse është drejtoresh dhe i ka 300 kredi.

z.Bekim Azizi: Edhe vitin e kaluar e kemi pas të njëjtin vendim, e ku pas një muaji e kemi ndryshu këtë vendim, e ku u kanë i propozuar Zjadini, pas një muaji e kemi hek, sepse nuk i plotëson kriteret.

z.Ali Bajrami: Elaborimi që e dha drejtori, besoj që është në përputhje me udhëzimet administrative dhe ne si grup parlamentar do ta votojmë këtë propozim vendim.

z.Jakup Demiri: Drejtor, pasi diskutuam atë ditë, kishte me qenë mirë me qenë një nga opozita në këtë përbërje, po ne si subjekt politik do të abstenojmë për shkak të emrit të anëtarit i cili është edhe kryetari i degës së LDK-së në Smirë, edhe kishte me qenë mirë me e ndërru këtë anëtar.

z.Zekirja Zuka: Kryetari i LDK-së në Smirë është Florent Ymeri.

z.Ekrem Abazi: Po me vjen shume keq, në bazë të këtij udhëzimi administrativ, me gjithë se përpara u përcaktu njëri dy tre muaj pa u hap konkursi u zgjedhe njeri, po me përjashtimin e personit nga këshilli në atë komision, atëherë i jetë çdo kryetari të komunës me e zgjedh vetë ka të do drejtor shkolle, drejtor çerdhe e kur ka qenë anëtar i këshillit të prindërve e ka pas pak më vështirë.

z.Naim Pira, kryesues i kuvendit: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes në votim për miratim. Me 12 vota pro, me 2 kundër, disa abstenime, kalon ky propozim.

Si pikë të katër kemi:

4. Propozim vendim për ndryshim plotësimi të Vendimit Nr.01-110/05-469, i cili vendim ka të bëjë rreth kodit financiar

A jeni pro miratimit të këtij propozim vendimi ju lutem me ngritje dore? Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë.

Si pikë të pestë kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit shpalljen ne diskutim publik rregulloren për taksa ngarkesa...


A jeni pro miratimit të këtij propozim vendimi ju lutem me ngrite dore? Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë.

Kryesuesi, z.Naim Pira: Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë seancë.

Mbledhja përfundoj me punë në ora 12:30 min.

Procesmbajtësi:

Fatlum Demiri



Kryesuesi i Kuvendit Komunal:

Naim Pira

